



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 584 prot.

Himarë, më 22.01. 2026

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “Për miratimin për transferimin e pasurisë të llojit kullotë, me nr. pasurie 68/119/15, e ndodhur në zonën kadastrale 1739, me sipërfaqe totale 2555 m2, nga pronësi e Bashkisë Himarë tek Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit”.

KESHILLIT BASHKIAK HIMARË,

Himarë

Në bazë të pikës 2, të nenit 8, pikës dh, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive te pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive” (i ndryshuar) pika 49 ; ligjit nr.9693/2007, “Për fondin kullosor”; VKM-në nr. 592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”; në vijim të shkresës nr.2572/1prot., të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë;

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projektvendimin “Për miratimin për transferimin e pasurisë të llojit kullotë, me nr. pasurie 68/119/15, e ndodhur në zonën kadastrale 1739, me sipërfaqe totale 2555 m2, nga pronësi e Bashkisë Himarë tek Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit”.
- Relacion: Mbi projektvendimin “Për miratimin për transferimin e pasurisë të llojit kullotë, me nr. pasurie 68/119/15, e ndodhur në zonën kadastrale 1739, me sipërfaqe totale 2555 m2, nga pronësi e Bashkisë Himarë tek Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit”
- Shkresa nr.2572/1prot., datë 15.12.2025, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Korporatës së Investimeve Shqiptare SH.A.

KRYETARI

Vangjel Tavo

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 584 / prot.

Himarë, më 22.01 . 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 4 , Datë 22.01 .2026

PËR

“MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË PASURISË TË LLOJIT KULLOTË, ME NR. PASURIE 68/119/15, E NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 1739, ME SIPËRFAQE TOTALE 2555 m², NGA PRONËSI E BASHKISË HIMARË TEK MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT”

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i përitësuar), neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe neni 54; VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive” (i ndryshuar) pika 49 ; ligjit nr.9693/2007, “Për fondin kullosor”; VKM-në nr. 592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”; në vijim të shkresës nr.2572/1prot., të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

VENDOSI:

1. Miratimin për transferimin e pasurisë të llojit kullotë, me nr. pasurie 68/119/15, e ndodhur në zonën kadastrale 1739, me sipërfaqe totale 2555 m², nga pronësi e Bashkisë Himarë tek Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI
Vangjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI

Erifil Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 584/prot.
12

Himarë, më 22.01 . 2026

RELACION:

MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË PASURISË TË LLOJIT KULLOTË, ME NR. PASURIE 68/119/15, E NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 1739, ME SIPËRFAQE TOTALE 2555 m², NGA PRONËSI E BASHKISË HIMARË TEK MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT”.

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt vendimi që po ju paraqesim vjen pasi kemi marrë dhe shqyrtuar kërkesën nr.2572/1prot., datë 18/12/2025 të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit me objekt:”Dërgohet për mendim projekt vendimi”.

Ky projektvendim paraqitet për shqyrtim dhe miratim me qëllim realizimin e transferimit të së drejtës së pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme të llojit **kullotë**, aktualisht në administrim dhe pronësi të Bashkisë Himarë, drejt Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

Transferimi i kësaj pasurie përbën një veprim të arsyetuar ligjërisht dhe funksionalisht, i cili synon përdorimin më efikas dhe në interes publik të territorit, në përputhje me politikat shtetërore për administrimin e pasurive publike dhe zhvillimin ekonomik, kulturor dhe inovativ. Duke qenë se pasuria në fjalë nuk përdoret aktualisht për funksione të drejtpërdrejta të shërbimeve vendore, kalimi i saj në pronësi të një institucioni qendror krijon mundësi konkrete për investime strategjike dhe zhvillim afatgjatë.

Ky veprim mbështetet në parimin e **menaxhimit racional të pronës publike**, duke synuar rritjen e vlerës së përdorimit të saj në funksion të interesit të përgjithshëm, si dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet pushtetit vendor dhe atij qendror.

I. Baza Ligjore

Ky relacion paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak, në mbështetje të:

- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar;

- VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive” (i ndryshuar).
- Ligji nr.9693/2007,“Për fondin kullor”.
- VKM nr.592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.
- Shkresa nr.**2572/1prot.**, datë **15.12.2025**, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Korporatës së Investimeve Shqiptare SH.A.

II. Qëllimi i projekt vendimit.

Ky projekt vendim synon miratimin e transferimit të pasurisë dhe synon vënien e saj në dispozicion të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit

për realizimin e funksioneve dhe projekteve që lidhen me misionin e kësaj ministrie, duke garantuar përdorim të ligjshëm, të planifikuar dhe në interes publik.Pasuria objekt shqyrtimi është:

- **Zona Kadastrale:** 1739
- **Numër Pasurie:** 68/119/15
- **Sipërfaqe:** 2,555 m²
- **Statusi Juridik:** Pronë shtetërore

Kjo pasuri rezulton e regjistruar si pronë shtetërore dhe është pjesë e dokumentacionit zyrtar të përcjellë me shkresën nr.2572/1prot, datë 15.12.2025, për t’u trajtuar në kuadër të procedurave të investimeve për interes publik. Pjesë e kësaj shkrese është dhe kartela e pasurisë së paluajtshme e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me kod Unik:1739008140.

Nëpërmjet shkresës së sipërcituar, Bashkia është vënë në dijeni mbi:

- Përfshirjen e pasurisë me ZK:1739, nr. pasurie 68/119/15 në projektin/investimin nw. interes publik;
- Nevojën për shprehje vullneti dhe bashkëpunim institucional nga ana e Këshillit Bashkiak;
- Detyrimet ligjore të njësisë së vetëqeverisjes vendore në zbatim të akteve normative në fuqi, lidhur me administrimin e pasurive shtetërore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

- Pasuria është e identifikuar qartë nga ana kadastrale dhe juridike;
- Procedura e propozuar është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- Vijimi i procesit nuk cënon interesin publik dhe pronësinë shtetërore, por synon zhvillimin ekonomik dhe institucional të territorit.

IV. Përfundime dhe propozim

Si përfundim, i propozojmë **Këshillit Bashkiak Himarë:**

1

Të marrë në shqyrtim shkresën nr. **2572/1 prot**, datë **15.12.2025**, dhe të miratojë vijimin e procedurave për pasurinë shtetërore me **ZK:1739, nr. pasurie 68/119/15, sipërfaqe 2,555 m²**;

Në përfundim, miratimi i këtij projektvendimi konsiderohet i domosdoshëm dhe i justifikuar, pasi garanton përdorim më efektiv të pasurisë publike, respektim të kuadrit ligjor dhe nxit zhvillimin institucional e ekonomik. Për këto arsye, propozohet miratimi i projektvendimit për transferimin e pasurisë së sipërpërmendur nga Bashkia Himarë tek Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.

KRYETARI
Vangjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi



10



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA HIMARË
SEKTORI I SEKRETARISË DHE I ARKIVIT
ZYRA E SEKRETARISË

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues: Ministria e Ekonomisë dhe Tregëtisë

Nr. 258/ prot.

Data 17.12.2023

Shkurtimi i lëndës: Dëgohet mundim për projektim

Për trajtim nga :	<u>dr. juridike ; dr. e bujqësisë ; dr. aseteve</u>
Struktura të tjera të ngarkuara	<u>Kryetari</u>
Me porosi :	

Afati : Normal {7 ditë} / Prioritet {3 ditë} / Urgjent {brenda ditës} / Pa afat /Për dëgjim / Tjetër: ditë /

Data 18.12.2023 Nr. prot. 932

KRYETARI I BASHKISË: Vangjel Tavo ME URDHËR

Marrë në dorëzim më: 18.12.2023

Nënshkrimi: _____

I kalon për trajtim drejtorisë: juridike ✓

Data 18.12.2023

Me porosi: drejtorisë së bujqësisë

Marrë në dorëzim: drejtorisë së aseteve

Nënshkrimi: _____

I kalon për trajtim sektorit: Kryetari

Data 18.12.2023

Me porosinë: _____


Nënshkrimi: _____

Marrë në dorëzim: _____

Trajtimi i materialit përfunduar me: _____ Specialisti

Trajtimi i materialit përfunduar me: _____ Përgjegjësi i sektorit

Trajtimi i materialit përfunduar me: _____ Drejtori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 1877/prot.

Tiranë, më 18.12.2025

Lënda: Dërgohet për mendim projektvendimi.

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Tiranë

MINISTRISË SË MJEDISIT

Tiranë

MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Tiranë

BASHKISË

Tiranë

BASHKISË

Vlorë

BASHKISË

Sarandë

BASHKISË

Elbasan

AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS

Tiranë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Tiranë

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE (INSTAT)

Tiranë

AVOKATIT TË POPULLIT

Tiranë

AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

Tiranë

KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Tiranë

KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Tiranë

KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Tiranë

“KORPORATËS SË INVESTIMEVE SHQIPTARE” SHA

Tiranë

Bashkëlidhur ju përcjellim për mendim projektvendimin “Për transferimin te Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore”, me nënprojekte “Korpusi i Institucioneve të Pavarura”, “Shtëpia e Fëmijëve Vlorë”, “Qendra për zhvillimin multifunksional”, “Copëzat”, së bashku me relacionin shpjegues.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të mendimit tuaj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, Datë _____ 2025

PËR

TRANSFERIMIN TE KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE TË PRONAVE
SHTETËRORE, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DISA INSTITUCIONEVE
SHTETËRORE, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË INVESTIMIT "PËR
ZHVILLIMIN DHE MENAXHIMIN E PRONAVE SHTETËRORE", ME
NËNPROJEKTE "KORPUSI I INSTITUCIONEVE TË PAVARURA", "SHTËPIA E
FËMIJËVE VLORË", "QENDRA PËR ZHVILLIMIN MULTIFUNKSIONAL",
"COPEZAT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, "Për Korporatën e Investimeve Shqiptare", të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe në zbatim të shkronjës "b", të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Transferimin në pronësi të shoqërisë aksionare "Korporata e Investimeve Shqiptare" me NIPT: M01917011D, të pronave shtetërore sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi, për realizimin e projekteve të investimit.
2. Autorizimin e shoqërisë aksionare "Korporata e Investimeve Shqiptare", vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, për të vepruar si zhvillues i pronave me funksion vetëm publik, në emër dhe për llogari të pronarit shtet, për pronat shtetërore, sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Korporata e Investimeve Shqiptare apo entiteti i krijuar prej saj zhvillon pronat e përcaktuara në shtojcën nr.1 dhe shtojcën nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi, në funksion të realizimit të projekteve të investimit, të cilat kanë si qëllim, ndër të tjera, përmbushjen e interesit publik.

4. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare dhe institucionet e përcaktuara në shtojcën nr. 3 bashkëlidhur këtij vendimi, që brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave dhe kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik, autoritetit në pronësi apo përgjegjësi administrimi të të cilit regjistrohet prona e re shtetërore që zhvillohet si rezultat i përmbushjes së kushtit të transferimit të pronës/autorizimit për zhvillim apo përmbushjes së interesit të Korporatës, kushtet e nevojat për dorëzimin e pronës së re.

5. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për hapjen e procedurës konkurruese për përzgjedhjen e partnerit privat, për secilin nga projektet e investimit, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare", të ndryshuar, për zhvillimin e pronave të shtojcës nr. 1 dhe nr. 2 nëpërmjet instrumentit ligjor të sipërmarrjes në përputhje me koncept idenë arkitekturore që do të dali fitues nga konkursi ndërkombëtar.

Autorizohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, që në të njëjtën procedurë, të asistojë Korporatën e Investimeve Shqiptare nëpërmjet hartimit të termave të referencës për projektidetë arkitekturore, hartimin e kriterëve të kualifikimit për projektuesit dhe kriterëve të vlerësimit paraprak e përfundimtar të projekteve arkitekturore.

Shpenzimet për shërbimet e parashikuara në këtë pikë mbulohen nga buxheti i Korporatës së Investimeve Shqiptare.

6. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për negocimin me subjekte private dhe publike me qëllim lidhjen e kontratës përkatëse për zhvillimin e pronave të transferuara në pronësi apo për të cilat ka autorizim zhvillimi, në funksion të realizimit të projekteve të investimit, bazuar në Vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

7. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, të kryejë veprimet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit, apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të projektit të investimit si dhe të sigurojë regjistrimin, në emër të Republikës së Shqipërisë dhe Korporatës së Investimeve Shqiptare, sipas parashikimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit, të pronave të reja shtetërore që do të krijohen në kuadër të projekteve të investimit.

8. Në funksion të zhvillimit të pronave të përcaktuara në këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar me prishjen e objekteve, pjesë e pronave të përcaktuara në shtojcën nr. 1 dhe në shtojcën nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi,

vetëm pasi ka siguruar vazhdimin e aktiviteteve të institucioneve publike, që përdorin/ administrojnë këto prona, në ambiente të tjera deri në marrjen në dorëzim të ambienteve të reja të ndërtuara, si dhe në zbatim të kreut II, pika 5 të VKM nr. 137, datë 6.3.2024 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitheozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, ngarkohet Korporata të kryejë procesin e konsolidimit të pronave të Shtojcave 1 dhe 2 në rast se konstatohet mospërputhje midis gjëndjes faktike dhe ligjore të pronës.

9. Në listat e pronave, që i bashkëlidhen Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 250, datë 24.4.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, i ndryshuar, të hiqen pronat shtetërore, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Statistikave (INSTAT), Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioni i Prokurimit Publik, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI
EDI RAMA

SHTOJCA NR. 1

Pronat që transferohen në pronësi të Korporatës

Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Sip. e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi
			Truall (m2)	Ndërtesë (m2)	
8602	24/1-T	4817	4817	-	Shtet
8602	24/1-ND	675	-	675	Shtet
8220	2/389	1036	1036	-	Shtet
8220	2/490	3032.5	3032.5	1110	Shtet
8220	2/491	3871.5	3871.5	1075	Shtet
3140	149/31	948.5	-	-	Shtet
8330	2/273	2474	2474	-	Shtet
8330	2/348	405	405	-	Shtet
8330	6/482	179	179	-	Shtet
8330	6/483	1504	1504	-	Shtet
1739	68/119/15	2555	-	-	Shtet
8340	6/71	109	-	-	Shtet
8642	24/232	310.49	310.49	-	Shtet
8642	24/535	19509.66	19509.66	-	Shtet
8210	2/47	394.49	-	-	Shtet

SHTOJCA NR. 2**Pronat me funksion publik për të cilat Korporata vepron si zhvillues**

Zona Kadastrale	Nr. Pasurise	Sip. e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi
			Truall (m2)	Ndërtesë (m2)	
8150	4/281	2381	2381	759	Shtet
8150	4/831	3045.6	3045.6	-	Shtet

SHTOJCA NR. 3

Institucionet publike të cilat lidhin Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Korporatën e Investimeve Shqiptare

Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Statistikave (INSTAT), Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

TRANSFERIMIN TE KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE
TË PRONAVE SHTETËRORE, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
TË DISA INSTITUCIONEVE SHTETËRORE, PËR REALIZIMIN E
PROJEKTIT TË INVESTIMIT “PËR ZHVILLIMIN DHE
MENAXHIMIN E PRONAVE SHTETËRORE”, ME NËNPROJEKTE
“KORPUSI I INSTITUCIONEVE TË PAVARURA”, “SHTËPIA E
FËMIJËVE VLORË”, “QENDRA PËR ZHVILLIMIN
MULTIFUNKSIONAL”, “COPEZAT”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky Projektvendim synon transferimin e disa pronave shtetërore në pronësi të Korporatës së Investimeve Shqiptare dhe kalimin e të drejtave të zhvillimit, në funksion të realizimit të disa nënprojekteve të investimit pjesë e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore”.

Projekti i investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore” konsiston në zhvillimin dhe transformimin e pronave dhe godinave shtetërore në Shqipëri, me një fokus të veçantë në qytetet kryesore të vendit ku tregu i pasurive të paluajtshme ka një rëndësi të konsiderueshme për ekonominë si dhe ku përqendrimi i godinave/ pronave me rëndësi sociale dhe kulturore është më i madh. Ky projekt mundësohet si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Korporatës së Investimeve Shqiptare (AIC), institucioneve publike që shprehin interesin për të marrë pjesë në zhvillim dhe partnerit privat, përzgjedhja e të cilit bëhet në bazë të një procedure sipas rregullave të përcaktuar në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar.

Projekti formohet nga disa nënprojekte investimi ku përfshihen dhe “Korpusi i Institucioneve të Pavarura”, “Shtëpia e Fëmijëve Vlorë”, “Copëzat”, “Qëndër për Zhvillimin Multifunksional”, të cilat lidhen me zhvillimin dhe menaxhimin e pronave/godinave shtetërore me funksione të dedikuara sipas marrëveshjes specifike që lidh AIC me partnerin privat. Qëllimi kryesor i projekteve të investimit është rritja e vlerës dhe efikasitetit/ funksionalitetit të pronave shtetërore përmes zhvillimeve të qëndrueshme dhe menaxhimit të përshtatshëm.

Në një prezantim më të detajuar objektivat dhe qëllimi i nënprojekteve pasqyrohen si më poshtë vijon:

- I. Nënprojekti “Korpusi i Institucioneve të Pavarura” është pjesë përbërëse e iniciativës më të gjerë të Korporatës së Investimeve Shqiptare (AIC) për “Zhvillimin dhe Menaxhimin e Pronave Shtetërore” dhe synon ndërtimin e një kompleksi të ri institucional modern duke përfshirë disa institucione të pavarura, me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme, të sigurt dhe moderne të punës për stafet e secilit institucion si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe jetesës së qytetarëve

Institucionet të cilat do të jenë pjesë e Korpusit të Institucioneve të Pavarura janë Instituti i Statistikave (INSTAT), Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Me anë të shkresës nr. 409 Prot., datë 07.02.2025, protokolluar pranë AIC me Nr. 123, Prot., datë 12.02.2025 Instituti i Statistikave (INSTAT) i është drejtuar Korporatës së Investimeve Shqiptare për kërkesë për bashkëpunim në lidhje me mjedise të reja pune, si pasojë e dëmeve dhe gjëndjes së godinës ekzistuese ku aktualisht ushtrojnë aktivitetet e cila ka nevojë për ndërhyrje dhe rikonstruktion.

Në vijim të saj kanë dërguar nevojat edhe Avokati i Popullit nëpërmjet shkresës nr. 247/1 Prot, datë 12.09.2025, protokolluar pranë AIC me Nr. 123/2, Prot., datë 16.09.2025, Komisioni i Prokurimit Publik nëpërmjet shkresës nr. 3084/2 Prot, datë 07.11.2025, protokolluar pranë AIC me Nr. 510/4, Prot., datë 12.11.2025, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nëpërmjet shkresës nr. 2790/1 Prot, datë 13.11.2025, protokolluar pranë AIC me

Nr. 510/5, Prot., datë 17.11.2025, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nëpërmjet shkresës nr. Prot, datë 07.11.2025, protokolluar pranë AIC me Nr. 510/4, Prot., datë 21.11.2025.

Ndërtimi i Korpusit do të lehtësojë aksesin e qytetarëve dhe bizneseve në shërbime të unifikuara e më transparente si dhe do të ndikojë drejtpërdrejt në rigjallërimin e zonës qendrore lindore të Tiranës, duke shndërruar pronat publike të amortizuara në hapësira administrative moderne, me ndikim të dukshëm estetik dhe funksional në zhvillimin e qytetit.

Pjesë e zhvillimit të këtij nënprojekti janë pasuritë:

1. Pasuria nr. 4/281 me sipërfaqe prej 2381 m2 truall dhe 759 m2 ndërtesë, në Zonën Kadastrale 8150, Tiranë;
2. Pasuria nr. 4/831 me sipërfaqe 3045.6 m2, në Zonën Kadastrale 8150, Tiranë.

II. Nënprojekti “Shtëpia e Fëmijëve Vlorë” synon zhvillimin e një godine multifunksionale dhe moderne, që do të përfshijë qendrën “Shtëpia e Fëmijëve Vlorë” si një strukturë të re të kujdesit, trajtimit dhe edukimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke e shndërruar atë në një model bashkëkohor të shërbimeve sociale të integruara në nivel vendor dhe kombëtar.

Ndërtimi i “Shtëpisë së Fëmijëve Vlorë” adreson një nevojë sociale kritike për një strukturë të re, të denjë dhe të sigurt për fëmijët në përkujdesje institucionale duke përfaqësuar një hap të rëndësishëm drejt reformimit të sistemit të mbrojtës sociale. Qëllimi i projektit është ndërtimi i një godine moderne dhe multifunksionale për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, e pajisur me hapësira të përshtatura për zhvillim, terapi, edukim dhe integrim shoqëror. Projekti synon përmirësimin e kushteve të jetesës dhe kujdesit si dhe sigurimin e standardeve bashkëkohore për trajtim dhe përfshirje sociale.

Pjesë e zhvillimit të këtij nënprojekti janë pasuritë:

1. Pasuria nr. 24/1-T me sipërfaqe 4817 m2 truall, në ZK 8602, Vlorë;
2. Pasuria nr. 24/1-ND me sipërfaqe 675 m2 ndërtesë, në ZK 8602, Vlorë.

III. Nënprojekti “Qendra për Zhvillimin Multifunksional” synon shfrytëzimin e pronave shtetërore në funksion të interesit publik, përmes ndërtimit të hapësirave moderne, funksionale dhe multifunksionale që do të mbështesin aktivitetin e institucioneve shtetërore dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës urbane të zonës.

Fusha e Aviacionit është një prej zonave që po kalon një transformim të rëndësishëm urban dhe që po kthehet në një qendër të re zhvillimore të kryeqytetit. Në këtë kontekst, ndërhyrja e AIC synon të vendosë bazat për një zhvillim të planifikuar dhe të koordinuar, ku prona publike të vihet në funksion të shërbimeve publike, edukimit, sigurisë apo bashkëpunimit ndërinstitucional.

Kjo qendër mund të përdoret me qëllim zhvillimin e infrastrukturës mbështetëse publike, si qendra trajnimi, objekte të shërbimeve publike, hapësira për bashkëpunim institucional apo qendra multifunksionale për nevoja operative të institucioneve të rendit dhe sigurisë.

Pjesë e zhvillimit të këtij nënprojekti janë pasuritë:

1. Pasuria nr. 2/490 me sipërfaqe 3032.5m², (nga të cilat truall 3032.5 m²; Ndërtesë 1110 m²), në Zonën Kadastrale nr. 8220, Tiranë;
2. Pasuria nr. 2/491 me sipërfaqe 3871.5m², (nga të cilat truall 3871.5 m²; ndërtesë 1075 m²), në Zonën Kadastrale nr. 8220, Tiranë;
3. Pasuria nr. 2/389 me sipërfaqe 1036 m² (truall), në Zonën Kadastrale nr. 8220, Tiranë.

IV. Nënprojekti “Copëzat” përbën një prej projekteve prioritare që Korporata ka implementuar në bashkëpunim me institucionet e zhvillimit të territorit dhe konsiston në zhvillimin nga pronari/zhvilluesi privat i pronave private dhe të pronave kufitare shtetërore, në këmbim të pjesës takuese të Korporatës në këtë projekt, sigurimin e një të mire për AIC si dhe një të mirë publike për partnerin publik.

Njëherazi ky projekt jo vetëm do të adresojë çështjen e hapësirave të braktisura dhe të pashfrytëzuara, por gjithashtu do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm urban, duke përmirësuar estetikën dhe funksionalitetin e qyteteve, si dhe rritjen e cilësisë së jetës.

Pjesë e zhvillimit të këtij nënprojekti janë pasuritë:

1. Pasuria nr. 149/31 me sipërfaqe 948.5 m² (pemëtore), në ZK 3140, Rradhimë;

2. Pasuria nr. 2/273 me sipërfaqe 2474 m² (truall), në ZK 8330, Tiranë;
3. Pasuria nr. 2/348 me sipërfaqe 405 m² (truall), në ZK 8330, Tiranë;
4. Pasuria nr. 6/482 me sipërfaqe 179 m² (truall), në ZK 8330, Tiranë;
5. Pasuria nr. 6/483 me sipërfaqe 1504 m² (truall), në ZK 8330, Tiranë;
6. Pasuria nr. 68/119/15 me sipërfaqe 2555 m² (kullotë), në ZK 1739, Himarë;
7. Pasuria nr. 6/71 me sipërfaqe 109 m² (rrugë), në ZK 8340, Tiranë;
8. Pasuria nr. 2/47 me sipërfaqe 394.49 m² (rrugë), në ZK 8210, Tiranë;
9. Pasuria nr. 24/232 me sipërfaqe 310.49 m² (shesh), në ZK 8642, Sarandë;
10. Pasuria nr. 24/535 me sipërfaqe 19509.66 m² (shesh), në ZK 8642, Sarandë.

Me kalimin e pronave shtetërore në pronësi apo të kalimit të të drejtave zhvillimore në favor të Korporatës së Investimeve Shqiptare, gjithashtu, synohet të lehtësohet dhe përshpejtohet procesi i zhvillimit të këtyre pasurive, në kuadër të të cilave, Korporata do të realizojë qëllimin publik nëpërmjet përdorimit të instrumentave ligjore përkatës. Në këtë mënyrë, do të garantohet gjithashtu dhe procesi transparent dhe efikas i zbatimit të projektit të investimit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është hartuar në përputhje me programin e qeverisë për një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe nxitje të investimeve.

Ky projektvendim nuk është parashikuar në programin analitik të akteve që do të miratohen për vitin 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Korporata e Investimeve Shqiptare është krijuar me ligj të veçantë si një shoqëri tregtare, me qëllim parësor, zhvillimin ekonomik të Republikës së Shqipërisë. Në funksion të realizimit të këtij qëllimi, është parashikuar që Korporata të operojë në treg për të përmirësuar menaxhimin e pronave publike, për të krijuar prona të reja, për të vënë këto prona në përdorim më eficient, për të përgatitur dhe zbatuar projekte investimi, si dhe për të mobilizuar kapital shtetëror dhe/ose privat.

Në kuadër të realizimit të qëllimeve të sipërpërmendura, Korporata mundësohet të disponojë prona shtetërore nën një regjim ligjor specifik, sipas përcaktimeve

të Nenit 7 të Ligjit 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” si dhe VKM Nr. 137, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar.

Bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM e sipërcituar, ky projektvendim parashikon transferimin në pronësi të Korporatës ose autorizimin për zhvillimin e disa pronave shtetërore, në funksion të realizimit të projekteve të investimit. Gjithashtu, me anë të këtij vendimi autorizohen institucionet publike të cituara në të për të lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi me Korporatën, e cila synon përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave dhe kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik, autoritetin në përgjegjësi administrimi apo pronësi të të cilit regjistrohet prona e re shtetërore, që zhvillohet si rezultat i përmbushjes së kushtit të transferimit të pronës/autorizimit për zhvillim.

Miratimi i projektvendimit parashikohet të rezultojë në një proces efikas të zhvillimit të pronës shtetërore, nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare, duke marrë në konsideratë ekspertizën e saj dhe mundësitë e bashkëpunimit me aktorë të tjerë të përfshirë në projekt. Rrjedhimisht, do të mundësohet dhe zbatimi më i shpejtë dhe efektiv i projektit, në përputhje me kuadrin ligjor rregullator.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me rendin juridik të brendshëm dhe propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe në zbatim të pikës 1, shkronja “b”, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi "Për transferimin të Korporatave Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projekteve të investimit", përcakton pronat shtetërore që do të kalojnë në pronësi të Korporatës apo për të cilat do të ketë autorizim zhvillimi, në funksion të realizimit të projekteve të investimit të cilat kanë si qëllim, ndër të tjera, përmbushjen e interesit publik ku synojnë krijimin e një mundësie për zhvillimin e pasurive të paluajtshme në funksion të përforcimit të infrastrukturës urbane në Shqipëri.

Nga pikëpamja teknike, projektvendimi ka 10 (dhjetë) pika dhe 3 (tre) shtojca, ku secila prej tyre përmban parashikime, të cilat gjenden të parashtruara në mënyrë të përmbledhur si më poshtë, duke u përqendruar kryesisht në çështjet kryesore.

1. Transferimin në pronësi të shoqërisë aksionare "Korporata e Investimeve Shqiptare" me NIPT: M01917011D, të pronave shtetërore sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi, për realizimin e projekteve të investimit.
2. Autorizimin e shoqërisë aksionare "Korporata e Investimeve Shqiptare", vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, për të vepruar si zhvillues i pronave me funksion vetëm publik, në emër dhe për llogari të pronarit shtet, për pronat shtetërore, sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Korporata e Investimeve Shqiptare apo entiteti i krijuar prej saj zhvillon pronat e përcaktuara në shtojcën nr.1 dhe shtojcën nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi, në funksion të realizimit të projekteve të investimit, të cilat kanë si qëllim, ndër të tjera, përmbushjen e interesit publik.
4. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare dhe institucionet e përcaktuara në shtojcën nr. 3 bashkëlidhur këtij vendimi, që brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave dhe kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik, autoritetit në

pronësi apo përgjegjësi administrimi të të cilit regjistrohet prona e re shtetërore që zhvillohet si rezultat i përmbushjes së kushtit të transferimit të pronës/ autorizimit për zhvillim apo përmbushjes së interesit të Korporatës, kushtet e nevojat për dorëzimin e pronës së re.

5. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për hapjen e procedurës konkurruese për përzgjedhjen e partnerit privat, për secilin nga projektet e investimit, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në formë të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, për zhvillimin e pronave të shtojcës nr. 1 dhe nr. 2 nëpërmjet instrumentit ligjor të sipërmarrjes në përputhje me koncept idenë arkitekturore që do të dali fitues nga konkursi ndërkombëtar.

Autorizohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, që në të njëjtën procedurë, të asistojë Korporatën e Investimeve Shqiptare nëpërmjet hartimit të termave të referencës për projektidetë arkitekturore, hartimin e kriterëve të kualifikimit për projektuesit dhe kriterëve të vlerësimit paraprak e përfundimtar të projektideve arkitekturore.

Shpenzimet për shërbimet e parashikuara në këtë pikë mbulohen nga buxheti i Korporatës së Investimeve Shqiptare.

6. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për negocimin me subjekte private dhe publike me qëllim lidhjen e kontratës përkatëse për zhvillimin e pronave të transferuara në pronësi apo për të cilat ka autorizim zhvillimi, në funksion të realizimit të projekteve të investimit, bazuar në Vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
7. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, të kryejë veprimet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit, apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të projektit të investimit si dhe të sigurojë regjistrimin, në emër të Republikës së Shqipërisë dhe Korporatës së Investimeve Shqiptare, sipas parashikimeve të

marrëveshjes së bashkëpunimit, të pronave të reja shtetërore që do të krijohen në kuadër të projekteve të investimit.

8. Në funksion të zhvillimit të pronave të përcaktuara në këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar me prishjen e objekteve, pjesë e pronave të përcaktuara në shtojcën nr. 1 dhe në shtojcën nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi, vetëm pasi ka siguruar vazhdimin e aktiviteteve të institucioneve publike, që përdorin/ administrojnë këto prona, në ambiente të tjera deri në marrjen në dorëzim të ambienteve të reja të ndërtuara, si dhe në zbatim të kreut II, pika 5 të VKM nr. 137, datë 6.3.2024 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, ngarkohet Korporata të kryejë procesin e konsolidimit të pronave të Shtojcave 1 dhe 2 në rast se konstatohet mospërputhje midis gjëndjes faktike dhe ligjore të pronës.
9. Në listat e pronave, që i bashkëlidhen Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 250, datë 24.4.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, i ndryshuar, të hiqen pronat shtetërore, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Statistikave (INSTAT), Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioni i Prokurimit Publik, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Shtojca nr. 1 me titull “Pronat që transferohen në pronësi të Korporatës”, e cila përmban në total 15 referenca pronash.

Shtojca nr. 2 me titull “Pronat me funksion publik për të cilat Korporata vepron si zhvillues”, e cila përmban në total 2 referenca pronash.

Shtojca nr. 3 me titull “Institucionet publike të cilat lidhin Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Korporatën e Investimeve Shqiptare”, të cilat janë: Ministria

e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Statistikave (INSTAT), Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Komisioni i Prokurimit Publik.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet për zbatimin e këtij projektvendimi Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Statistikave (INSTAT), Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioni i Prokurimit Publik, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, referuar praktikës së përcjellë nga Korporata Shqiptare e Investimeve për propozimin e tij në Këshillin e Ministrave. Projektvendimi i është dërguar për mendim nëpërmjet sistemit e-akte dhe me shkresë zyrtare pranë:

- Ministrisë së Drejtësisë me qëllim sigurimin e përputhshmërisë ligjore të dispozitave që parashikon projektvendimi.
- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shkak se në pasurinë nr. 24/1-T, në Zonën Kadastrale 8602, Vlorë, pjesë e nënprojektit “Shtëpia e Fëmijëve Vlorë”, ndodhet ndërtesa me nr. pasurie 24/1-ND, vol. 17, fq. 42, në pronësi të qendrës “Shtëpia e Fëmijëve Vlorë”, e cila ushtron veprimtarinë e saj në fushën e shërbimeve të kujdesit, trajtimit dhe edukimit për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Ministrisë së Brendshme, meqenëse kjo ministri është ndër institucionet publike të cilat, në zbatim të këtij projektvendimi, do të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me Korporatën e Investimeve Shqiptare.
- Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për shkak se, sipas kartelës së pasurisë, për pasurinë nr. 149/31, në Zonën Kadastrale 3140, rezulton se lloji i pasurisë është “pemëtores”, dhe se realizimi i transferimit kërkon marrjen paraprake të miratimit nga ministria si institucion përgjegjës.

- Ministrisë së Mjedisit dhe Bashkisë Himarë, për shkak se, sipas kartelës së pasurisë, për pasurinë nr. 68/119/15, në Zonën Kadastrale 1739, rezulton se lloji i pasurisë është “kullotë”, e krijuar si pasojë e ndarjes së pasurisë nr. 68/119. Duke qenë se pasuritë me destinacion “kullotë” administrohen sipas Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për menaxhimin e fondit të kullotave dhe livadheve”, i ndryshuar, i cili përcakton se kalimi, ndryshimi i destinacionit apo dhënia në përdorim e tyre kërkon miratimin e autoriteteve përgjegjëse, ky projektvendim – që parashikon kalimin e pasurisë në pronësi të Korporatës së Investimeve Shqiptare – kërkon marrjen paraprake të vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë dhe të Ministrisë së Mjedisit, në cilësinë e organit përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e fondit të kullotave.
- Bashkisë Tiranë, për shkak se, sipas kartelave të pasurive, për pasurinë nr. 6/71, në Zonën Kadastrale 8340, si dhe për pasurinë nr. 2/47, në Zonën Kadastrale 8210, rezulton se lloji i pasurisë është “rrugë”, dhe se realizimi i kalimit të këtyre pasurive publike në pronësi kërkon marrjen paraprake të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë.
- Bashkisë Sarandë, për shkak se, sipas kartelave të pasurive, për pasurinë nr. 24/232 dhe nr. 24/535, në Zonën Kadastrale 8642, rezulton se lloji i pasurisë është “shesh”, dhe se realizimi i kalimit të këtyre pasurive publike në pronësi kërkon marrjen paraprake të vendimit të Këshillit Bashkiak Sarandë.
- Institutit të Statistikave (INSTAT), në vijim të kërkesës së shprehur prej këtij institucioni për sigurimin e mjediseve të përshtatshme të punës, në kuadër të nënprojektit “Korpusi i Institucioneve të Pavarura”, pjesë përbërëse e projektit të investimit që parashikohet në këtë projektvendim. Kjo kërkesë bazohet në shkresën nr. 409 prot., datë 07.02.2025 të INSTAT-it, me të cilën evidentohet gjendja strukturore e godinës ekzistuese, e klasifikuar me nivel dëmtimi DS4 (rikonstruktion), si dhe pamundësia për vijimin e sigurt të aktivitetit institucional në ambientet aktuale.
- Komisionit të Prokurimit Publik, në vijim të kërkesës së shprehur prej këtij institucioni për përfshirje në nënprojektin “Korpusi i Institucioneve të Pavarura”, pjesë përbërëse e projektit të investimit që parashikohet në këtë projektvendim. Kjo përfshirje bazohet në shkresën e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 3084/1 prot., datë 07.11.2025, nëpërmjet së cilës janë

paraqitur nevojat institucionale për sigurimin e mjediseve të reja të punës, si dhe argumentimi për funksionimin efikas të institucionit, në përputhje me kompetencat e tij ligjore dhe rolin kushtetues si organ i pavarur.



- Institucionit të Avokatit të Popullit, në vijim të shkresës nr. 247/1 prot., datë 12.09.2025, me të cilën është shprehur interes dhe miratim në parim për bashkëpunim në kuadër të projektit “Zhvillimi dhe Menaxhimi i Godinave Shtetërore”, konkretisht për nënprojektin “Korpusi i Institucioneve të Pavarura”. Përfshirja e këtij institucioni lidhet me faktin se godina ku ushtron aktivitet Instituti i Statistikave, e cila paraqet probleme strukturore si pasojë e dëmtimeve nga tërmeti i vitit 2019, është pronë kufitare me ambientet ku ushtron aktivitetin Institucioni i Avokatit të Popullit.
- Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në vijim të kërkesës së këtij institucioni për përcjelljen e nevojave institucionale në kuadër të projektit “Korpusi i Institucioneve të Pavarura”. Me shkresën nr. 898/1 prot., datë 20.11.2025, Komisioneri ka informuar mbi rëndësinë strategjike të këtij projekti, si një iniciativë që synon krijimin e një kompleksi të integruar zyrash për institucione kushtetuese dhe të pavarura të krijuara me ligj, në funksion të përmirësimit të kushteve të punës, rritjes së efektivitetit organizativ dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitutional.
- Autoritetit të Konkurrencës, meqenëse ky institucion, në zbatim të këtij projektvendimi, do të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Korporatën e Investimeve Shqiptare për realizimin e projekteve të investimit.
- Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, meqenëse ky institucion, në zbatim të këtij projektvendimi, do të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Korporatën e Investimeve Shqiptare për realizimin e projekteve të investimit.
- Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.
- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
- Korporatës së Investimeve Shqiptare.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim krijon efekte financiare të cilat mbulohen nga Korporata e Investimeve Shqiptare.

MINISTRI

Delina Ibrahimaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1739008140

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1739, Lloji i Pasurisë: KULLOTE, Nr. i Pasurisë: 68/119/15, Sipërfaqja Totale 2555 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-136-(115-D), Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia HIMARE, Rruga GJILEK, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 1, Dt. 26/11/2025), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTETI, Nr. Identifikimi/NIPT R0000000SH, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Regjistrim i bashkimit, ose ndarjes të pasurisë së paluajtshme, Nr. 1, Datë: 26/11/2025

Regjistruar: Nr. 00002632, Datë: 26/11/2025

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: kjo pasuri vjen nga ndarja e pasuris 68/119

DREJTORI
Erisad Jusufaj

Arten
Nelaj

Digitally signed by:
Arten Nelaj
Date: 2025.12.05
03:29:21 +02'00'

Erisad
Jusufaj

Digitally signed by:
Erisad Jusufaj
Date: 2025.12.05
06:14:23 +02'00'

Data e lëshimit 05/12/2025



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2025/12/05 15:30:44 +02'00'
MD1917011D2025120515303683ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE : 1739

KODI UNIK : 1739008140

NUMRI I PASURISË : 68/119/15

INDEX I HARTES : K-34-136-(115-C)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



Vanessa
Bylo

Digitally signed by:
Vanessa Bylo
Date: 2025.12.05
03:26:15 +02'00'

Arten
Najm

Digitally signed by:
Arten Najm
Date: 2025.12.05
03:30:30 +02'00'

Erisad
Jusufaj

Digitally signed by:
Erisad Jusufaj
Date: 2025.12.05
06:14:07 +02'00'

DREJTORI :

Data e lëshimit :

Nr Serial :

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2025/12/05 15:27:37 +02'00'
M01917011D2025120515273050014



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë

SHPJEGUES :



PARCELA



NDERTESA

